

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2020

PËR

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË KOMBËTARE TE LLOGARITJES
SË PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Të dhenat mbi rrezatimin diellor sipas ndarjeve administrative dhe për gjerësinë gjeografike të Shqipërisë, sigurohen nga institucionet shtetërore që monitorojnë klimën dhe miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie.
3. Të dhënat klimatike që përfshijnë temperaturat minimale dhe maksimale javore, por edhe rrezatimin direkt ditë/mujor në W/m^2 , së bashku me lagështinë relative, sigurohen nga institucionet shtetërore që monitorojnë klimën dhe miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi kësaj metodologjie.
4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficencën e Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E KËRKESAVE MINIMALE TË PERFORMANCËS SË
ENERGJISË SË NDËRTEHAVE DHE TË ELEMENTEVE TË
NDËRTEHAVE

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij vendimi është të vendosë Metodën Unike ose mjetin e vetëm për llogaritjen e nivelit të konsumit të energjisë në përputhje me kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave, me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e certifikatave të performancës së energjisë të llogaritur përmes Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes indikatorin dhe/ose treguesin e Performancës së Energjisë në Ndërtesa (PEN).

Në këtë aspekt Metodologjia PEN ka për qëllim të përcaktojë të gjitha detajet e llogaritjes që do të përdoren për vlerësimin numerik (të indikatorit/treguesit) të performancës së energjisë në ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese në të gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuptim Metodologjia do të përdoret:

- Për të demonstruar përputhshmërinë e një ndërtese në projektim dhe fazat e tjera, me Kërkesat Minimale të Performancës së Energjisë të përcaktuara në VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 “Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave”.
- Për të demonstruar që llogaritja e treguesit të PEN [kWh/m²vit] të Nevojës për Energji të ndërtesës Aktuale (NEA) do të vlerësohet përkundrejt normës të synuar të Nevojës për Energji për një m² të ndërtesës Referente (NER). Ndërtesa Referente në këtë metodologji do të shqyrtohet në përputhje me VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 dhe parashikon ndërmarjen e të gjitha masave të duhura për efikasitetin e energjisë që do të aplikohen në të ardhmen në Ndërtesën Aktuale.
- Për të gjeneruar nëpërmjet Programit Kompjuterik që do të miratohet nga Ministria përgjegjëse për Energjinë dhe AKSHI, të Certifikatave të Performancës së Energjisë (CPE) për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese që do të rinovohen. Programi Kompjuterik i Miratuar është në përputhje me algoritmet, kërkesat minimale dhe të dhenat që përmban kjo Metodologji.

Në thelb vendimi parashikon një metodë e cila është e detyrueshme të respektohet nga të gjithë grupet e interesit dhe sidomos nga audituesit e energjisë në ndërtesa të cilët gjenerojnë përmes algoritmeve dhe motorit të llogaritjeve të parashikuara në këtë Metodologji, Certifikaten e Performancës së Energjisë (CPE).

Nga ana tjetër CPE klasifikon ndërtesat për efikasitetin e energjisë që ato performojnë, pa dallim, jo vetëm tek ndërtesat e reja që në fazën e projektimit, por edhe tek ndërtesat ekzistuese kur këto të fundit kërkohet të rinovohen nëpërmjet një leje në bashki, apo jepen me qera dhe shiten.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi i këtij projektvendimi është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2020, si dhe në Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2020-2022.

Ky projektvendim është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për performancën e energjisë së ndërtesave dhe është përgatitur në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Hartimi i këtij projektvendimi është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Nënkomitetit të 8-të BE-Shqipëri të datës 30 mars 2017, rekomandimet e Komitetit të SAA të datës 1 mars 2018 për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal, si edhe rekomandimeve të Progres Raportit të BE për Shqipërinë (17.04.2018), lidhur me hartimin e legjislacionit sekondar në zbatim të ligjit për efikasitetin e energjisë dhe të performancës së energjisë në ndërtesa.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria si pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ka për detyrë të hartojë legjislacionin për efikasitetin e energjisë në ndërtesa dhe për t’u përfaqësuar me legjislacionin e BE. Neni 7 i Direktivës Europiane 2010/31/BE për performancën e energjisë së ndërtesave (EPBD) kërkon që Shtetet Anëtare (dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë) të marrin masat e nevojshme për të siguruar që kur ndërtesat ekzistuese i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm apo rikonstruksioni, performanca energjetike e ndërtesës ose pjesa e rinovuar e saj të përmirësohet në mënyrë të tillë, që të përmbushë kërkesat minimale të performancës së energjisë për aq sa kjo është teknikisht, funksionalisht dhe ekonomikisht e mundur.

Ndërkohë neni 3 i kësaj Direktive parashikon gjithashtu që Shtetet Anëtare (dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë) të marrin masat e nevojshme për të siguruar në kushtet e tyre klimatike të vend-ndodhjes, përpueshmërisë me tipologjinë e ndërtesave, historikun e ndërtimeve, materialet e përdorura në teritoret e tyre, si edhe të metodave të deriatëhershme të llogaritjeve, një metodë unike të llogaritjeve të treguesit të performancës. Argumenti për të përqasur një Metodologji në kushtet e Shqipërisë, lind për shkakun se asnjëherë më parë nuk është përdorur një metodë unike e miratuar me VKM, e cila të vendosë në balancë konsumin e parashikuar në harkun e një viti të ndërtesës me efikasitet të ulët (ndërtesa Aktuale) e cila do të tregonte realisht shkallën e lartë të konsumit në kushtet e komfortit të parashikuar në Kërkesat Minimale të VKM 537, dt. 08.07.2020. Kjo do të thotë se për të arritur të ndërtohet me kushte energjetike efikente, ndërtesa jo-efikente duhet të ketë një bazë krahasimi me një ndërtesë Referente, tek e cila do të aplikohen jo vetem Kërkesat Minimale (VKM 537/2020) të komfortit por edhe të gjitha masat e mundshme të ndërhyrjeve, siç janë izolimi termik i mbeshtjellses të mureve të jashtme (sistemi ‘Kapot’), vendosja e dritareve me koeficiente të ulët të transmetimit të nxehtësisë (xham dopjo, dritare plastike etj.), çati e soleta të izoluara me shtresa, sisteme ngrohje/ftohje me efikasitet të lartë, prodhim të ujit të ngrohtë të ndihmuar nga panelet diellore, ndriçim efikas dhe ventilim të arsyeshme.

Në dy rastet e mësipërme Metodologjia PEN jep përgjigje në kuptimin e termave matematike dhe kushteve të ngjashme të llogaritjes me qëllim vendosjen në të njëjtën bazë krahasimi të dy ndërtesave, asaj Aktuale dhe asaj Referente.

Deri sot ekziston vetëm një metode stacionare e parashikuar vetëm për ngrohjen në VKM nr. 38 date 16.01.2003 “*Per miratimin e normave, te rregullave dhe kushteve te projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehtesise ne ndertesave*” e cila thajse, nuk u zbatua ndonjehere dhe sot stoku i ndërtesave që nga “bum”-i i ndërtimeve në vitet 2000-2008 është ende i pa izoluar termikisht dhe kjo situatë vazhdon edhe sot. Ndërtesat e stokut të derisotëm llogariten të konsumojnë rreth 38% të energjisë elektrike dhe thajse 22% lëndë fosile për të ruajtur kushtet e komfortit, të cilat rriten nga viti në vit.

Pas daljes se ligjit 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” ky është akti, që vendos metodologjine unike kombëtare për llogaritjet e indikatorit/treguesit të performancës për të respektuar kriteret minimale të performancës së energjisë që në fazën e projektimit deri në kolaudimin e ndërtesave të reja dhe për ato egzistuese që rinovohen.

Kështu në zbatim të këtij ligji dhe ligjit të efikasitetit të energjisë, MIE ka miratuar aktet e mëposhtme:

1. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 537, datë 08.07.2020 “Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të

Elementëve të Ndërtesave”

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.342, datë 22.05.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”;
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.256, date 27.03.2020 Per metodologjine për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësi dhe elementeve të ndërtesave
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.709, datë 1.12.2017 “Për miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020”
6. VKM Nr. 852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Eficencën e Energjisë”

dhe gjatë vitit 2020 ka parashikuar hartimin e akteve nënligjore:

1. Projektvendimi “Per Procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të “Certifikatës për performancën e energjisë” të ndërtesave përkatëse;
2. Projektvendim "Për Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë” të ndërtesave"

Këto projekt-vendime plotësojnë njëri-tjetrin dhe i japin fuqi zbatuese përkatësisht ligjit nr.116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”. Gjithashtu ky Ligj (116/2016) përcakton detyrime për hartimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ato egzistuese që do t’i nështrohen një rinovimi të rëndësishëm, pra në zbatim të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, paraqitja e projektit të eficiencës energjetike në rastin e VKM 408/2015 dhe VKM 537/2020 është i detyrueshëm. Duke përcaktuar Metodologjinë e llogaritjes së performancës së energjisë për ndërtesat dhe elementët e ndërtesave, si dhe të sistemeve teknike, firmat projektuese gjatë përgatitjes së projektit për ndërtime të reja, si dhe për shtesa apo rinovime të rëndësishme/rikonstruksione në ndërtimet ekzistuese, përmes kësaj Metodologjie dhe audituesve të energjisë në ndërtesa duhet të parashikojnë të gjitha aspektet llogaritese të lidhura me ndërtimin si:

1. Llogaritjen e nevojatve/kërkesave vjetore të energjisë të nevojshme për plotësimin e nevojave në përputhje me Kerkesat Minimale (VKM 537/2020) brenda sipërfaqes të banueshme të ndërtesës,

2. Përmes Metodologjisë dhe Programit Kompjuterik të Miratuar është e domosdoshme të llogariten:
 - a. Kërkesën për energji për plotësimin e nevojave për ngrohjen e hapësirave
 - b. Kërkesën për energji për plotësimin e nevojave për ftohjen e hapësirave
 - c. Kërkesën për energji për plotësimin e nevojave për ventilimin e hapësirave
 - d. Kërkesën për energji për plotësimin e nevojave për ujë të ngrohtë sanitar
 - e. Kërkesën për energji për plotësimin e nevojave energjetike për ndriçim
 - f. Konsumin vjetor të energjisë për ngrohje
 - g. Konsumin vjetor të energjisë për ftohje
 - h. Konsumin vjetor të energjisë për ujë të ngrohtë
 - i. Konsumi i energjisë për ventilim
 - j. Konsumi i energjisë për ndriçimin
 - k. Sasine e energjisë të prodhuar për llogari të vetëplotësimin të nevojave për energji të ndërtesës nga Sistemet diellore termike dhe fotovoltaike.
 - l. Sasinë e energjisë të prodhuar dhe/ose të furnizuar nga Sistemet e Kombinuara të prodhimit të njëkohshëm të Nxehtësisë dhe të Energjisë elektrike (CHP – Combined Heat and Power).

Kërkesat minimale të performancës së energjisë të miratuara me VKM 537 dt. 08.07.2020 në këtë projektvendim do të integrohen në të gjithë algoritmet e Metodologjisë dhe kryesisht në të dhënat hyrëse për:

1. **mbështjelljen izoluese** të ndërtesave të reja dhe elementëve të tyre, edhe gjithashtu edhe izolimin e mbështjelljes në ndërtesat ekzistuese dhe njësitëve të tyre kur këto të fundit i nështrohen një rinovimi apo ristrukturimi të rëndësishëm;
2. **sistemet teknike të ndërtesës** ku përfshihen sistemet eficientë, ose pajisjet që konsumojnë energjinë fundore të ngrohjes, ftohjes, ujit të ngrohtë, ventilimit dhe ndriçimit;
3. **performancën e integruar të energjisë** së ndërtesës si një sistem funksional të integruar mes ndërtesës dhe impiantit ose sistemit teknik.
4. për ndërtesat me performancë **“afër zero energji”**

Projektvendimi parashikon vendosjen në algoritmet llogaritëse vlerat maksimale të lejuara të koeficientit të përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë U (vlera-U e shprehur në $W/m^2.K$), i cili shpreh humbjet e nxehtësisë me transmetim nga mbështjellësja për $1 m^2$ dhe diferencë të temperaturës me $1^\circ C$ (ku përfshihen muret, dritaret, dyert, catia dhe dyshemja e mbështetur me tokën) për ndërtesat e reja dhe njësitëve të ndërtesave të reja si edhe të ndërtesave ekzistuese dhe njësitëve të ndërtesave ekzistuese, kur ato i nështrohen një rinovimi apo ristrukturimi të rëndësishëm dhe/ose kur shtohen/zgjerohen;

Për të kontrolluar kërkesat minimale të performancës së energjisë përmes metodologjisë do të kryhen llogaritje të konsumit total vjetor të energjisë së

ndërtesës për një metër katror të saj, që përfshin energjinë e kërkuar *për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë sanitar dhe ndriçim* që cojnë në gjenerimin Certifikatës së Performancës së Energjisë (ÇPE). Llogaritjet kryhen duke përdorur këtë Metodologji unike Kombëtare të Llogaritjes së performancës së integruar të energjisë së ndërtesave të reja apo të rinovuara, si edhe të njësive të këtyre ndërtesave, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa” dhe programin kompjuterik të miratuar.

Pasi llogaritjet e kryera përmes kësaj Metodologjie për konsumin e parashikuar në Ndërtesat aktuale dhe ato që do të projektohen, konsiderohet se është në përputhje me kërkesat minimale të performancës së energjisë, nëse vlera e llogaritur e shkallës së efikasitetit të energjisë primare në ÇPE, (raporti i energjisë së harxhuar në ndërtesën aktuale ndaj energjisë së harxhuar në ndërtesën referente) është më e vogël ose e barabartë me 50;

Përparësitë e këtij projektvendimi:

1. zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave, lidhet me:

- saktësimin përmes llogaritjeve të treguesit/indiktorit PEN për ndërtesën Aktuale dhe atë Referente, raporti i të cilave mundëson lëshimin e Certifikatës së performancës së Energjisë (ÇPE), e cila përcakton klasën e energjise së ndërtesës.
- ÇPE ndikon në tregun e shitjeve të ndërtesave duke informuar konsumatorin dhe rritur vlerën e pasurive të paluajtshme për ndërtesat që përputhen me kërkesat minimale të këtij projektvendimi.

2. Ne nivel kombëtar, zbatimi i këtij projektvendimi:

- Mbështet zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Efikasitetit të Energjisë;
- Përmirëson sigurinë energjetike
- Rrit konkurrueshmërinë e tregut të ndërtesave dhe të ekonomisë;
- Ul buxhetin e alokuar për faturat e energjisë elektrike dhe energjise termike për ndërtesat publike
- Kontribuon në zhvillimin me karbon të ulët

Mbi bazën e studimeve të kryera ne nivel evropian¹ sektori i ndërtimit është konsumatori më i madh i energjise dhe nga observimet e bëra rezulton se 75% e ndërtesave ne BE janë inefficente nga ana energjetike. Investimi në rinovimin e këtyre ndërtesave deri ne vitin 2030 do të çojë në një reduktim prej 36% të konsumit të energjisë.

¹<https://www.buildup.eu/en/news/overview-socioeconomic-and-technical-approaches-building-stock-renovation>

Për Shqipërinë sipas Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2016-2020 në vitin 2030, ngrohja e hapësirës, ngrohja e ujit, dhe ftohja e hapësirës do të jenë përgjegjëse respektivisht për 56%, 15% dhe 29% të konsumit përfundimtar të energjisë. Prandaj zbatimi i legjislacionit të performancës së energjisë në ndërtesa përfshi këtë projektvendim, synon të uli kërkesën për energji në të ardhmen në këtë sektor.

Metodologjia PEN dhe integrimi në përmbajtjen e saj të Kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave, që do t'i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm, do t'i japë shtysë shume të madhe kalkulimeve lidhur me nivelin optimal të kostos, pra do të mundësojë që teknikisht dhe praktikisht kosto optimale të jetë i realizueshëm dhe ekonomikisht i justifikueshëm për të gjithë jetëgjatësinë e ndërtesës;

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës. Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Projektvendimi është në përputhje me legjislacionin evropian, konkretisht me Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për performancën e energjisë së ndërtesave”. Kjo Direktivë është transpozuar plotësisht me ligjin 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

V. VLERËSIMI I SHKALLES SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi synon të transpozojë plotësisht legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për performancën e energjisë së ndërtesave sipas tabelës së përputhshmërisë, bashkëlidhur këtij projektvendimi. Ky projektakt është në përputhje me *acquis* të rregulloreve që pasojnë këtë direktive të BE.

Projektvendimi është asistuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjise në Vjene nëpërmjet programit “REEP Plus” të financuar nga EBRD gjatë vitit 2019. Asiatenca ndeshi me një sërë vështirësish për shkak të bazës të të dhënave klimatike të limituara lidhur me temperaturat historike dhe diellëzimin nga burime zyrtare të cilat në Metodologjinë PEN lidhen drejt për drejt me konsumin energjetik të ndërtesave që llogariten

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT

VENDIMIT

Projektvendimi, është i ndërtuar nga 3 pika dhe pjesa narrative e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa e vendosur në 6 Kapituj.

Përmbajtja e vendimit ka të bëjë me:

Pjesën e parë Miratuese të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pika e dytë ka të bëjë me mungesën në të dhënat klimatike që përfshijnë temperaturat minimale dhe maksimale ditore/javore historike të 5 viteve të fundit, por edhe rrezatimin direkt ditor/javor në W/m^2 . Këto të dhëna do të sigurohen nga institucionet shtetërore që monitorojne klimën (motin) dhe do të jenë aneks i Metodologjisë. Sipas një Udhëzimi që miratohet nga ministri pergjegjes per energjine brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi do të jepet një bazë të dhënash për temperaturat dhe rrezatimin diellor i sili do të jetë pjesë integrale e Metodologjisë.

Pika e tretë përcakton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë përgjegjëse për Eficencën e Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 (tre) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Përmbajtja narrative e Metodologjisë është ndarë në 6 kapituj që kanë këtë përmbajtje:

Kapitulli 1. Është përmbajtja e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa, ku janë sqaruar, Objektivi, Qëllimi, Fushëveprimi, Standardet e perdoruara për llogaritjet, arkitekturën e Programit Kompjuterik të Miratuar (Software) dhe të dhënat hyrëse të llogaritjeve që kryen programi. Një element i rëndësishëm janë të dhënat zyrtare dhe burimet e informacionit që janë përdorur.

Kapitulli 2. Ka dhënë një përshkrim të shkurtër për algoritmat e llogaritjeve, Metodën e perzgjedhur e llogaritjeve, Procedurat e llogaritjes së kërkesave të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e hapësirave. Janë dhënë se cilat janë pritshmëritë e parametrave që do të gjenden siç janë nevojat e energjisë për ngrohje, për ftohjen, totalin e nxehtësisë të transmetuar (humbjet me transmetim) dhe i burimeve të brëndshme të nxehtësisë (përfitimeve), humbjet totale të nxehtësisë me transmetim, Vlerat U dhe temperaturat llogaritëse të parashikuara në kërkesat minimale, përfitimet e Nxehtësisë, burimet e brëndshme të nxehtësisë, përfitimet e nxehtësisë diellore nëpërmjet strukturave transparente, llogaritja e faktorit reduktues të diellit nga hijezimi, llogaritja e fraksionit të ponderuar të kohës së ponderimit të hijezimit për mbrojtjen nga dielli, llogaritja e

transmetimit total të energjisë diellore përmes dritares kur hijëzimi ose perdja mbrojtëse diellore janë aktive, faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë, faktori i shfrytëzimit të humbjeve në ftohje.

Konstantja kohore e ndërtesës në funksion të mënyres së ngrohjes/ftohjes dhe kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës shërben për të dhënë metodën për regjim konstant ngrohje/ftohje dhe pothuajse të vazhdueshem, bazuar në metodën llogaritëse të metodës javore.

Korrektimet për ngrohje/ftohje me ndërprerje, metoda javore do të përcaktojnë Kërkesat për energji vjetore për ngrohje/ftohje, ventilim për një zonë të ndërtesës si dhe kërkesa për ujë të ngrohtë sanitar (UNS) dhe vlerësimi i nevojave energjetike për ndriçim për të gjetur konsumin e energjisë për ngrohje/ftohje, për ujë të ngrohtësi dhe sistemet ndihmëse të Energjisë Diellore termike ose PV/eolike.

Kapitulli 3. Vendos të dhënat hyrëse standarde në lidhje me përcaktimin e përfitimeve të brendshme, anën ndërtimore, burimet primare energjetike, sistemet me emetime të ulta të CO₂, të dhënat Klimatike, faktorët e emetimit të lëndëve djegëse si dhe faktorët e energjisë primare.

Ndriçimi, matjet dhe konvencionet në metodat të aplikuara në sistemet alternative me efikasitet të lartë janë gjithashtu pjesë e këtij kapitulli për të dhënat hyrëse në algoritme dhe formulime.

Kapitulli 5. Jepet protokollin e llogaritjeve, vlerësimi dhe norma e vlerësimit të PEN. Një seksion i veçantë ze përshkrimi dhe forma e Çertifikatës së Performancës së Energjisë (ÇPE) ku, Kërkesat Minimale për Performancën e Energjisë në Ndërtesa jep llogaritjen e Vlerësimit të Nivelit Relativ të Konsumit dhe shkallën e vlerësimit.

Ky kapitull jep konsideratat për Ndërtesën Referente tek e cila dallohen elementet kryesore që transmetojnë/absorbojnë energjinë si, dritaret, dyert, ndriçimi në çati ku densiteti i fuqisë së ndriçimit është një nga elementët bazë.

Ndërtesa Aktuale si ndërtesa e marrë në shqyrtim është ajo njësi që merr në konsideratë mungesën e masave për Efikasitetin e energjisë ku, gjykohet nga audituesi konstruksioni ndërtimor i mbështjelljes së ndërtesës, ndriçimi, mbështjellja dhe pjesa e brendshme e ndërtesës, të cilat reflektojnë konsumin e lartë.

Kapitulli 6. Është përshkruar metoda e llogaritjes për parametrin e performancës termike Gvt, koeficienti i humbjes volumetrike të nxehtësisë, Gvt, përshkrim për metodologjinë ekzistuese për llogaritjen e GV sipas VKM. 38, 16/01/2003, si edhe llogaritjen e humbjeve në lidhje me infiltrimin/ventilimin e pakontrolluar në ndërtesë dhe ventilimin mekanik së bashku me humbjet për transmetimin e nxehtësisë nga muret, lidhjet/nyjet jepet analiza e humbjeve termike lokale koeficienti Gv i humbjeve volumore të nxehtësisë si dhe rregullat për ndarjen e zonave.

Kapitulli 6. Ky kapitull jep bazat e të dhënave të aktiviteteve bazë që futen brenda formulave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes, si edhe llojet e ndërtesave sipas orareve të aktiviteteve.

Së fundi, Metodologjia permban dy anekse të dhenash dhe tabelen 1 dhe 2 të shtojcës I të VKM 537 dt. 08.07.2020

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Agjencia për Eficiencën e Energjisë

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Projektvendimi është përgatitur nga Sektori i Politikave dhe Strategjive në Fushën e Energjisë dhe Industrisë, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë gjatë vitit 2019/2020, në bashkëpunim me Agjensinë për Eficencë të Energjisë.

Ky projektvendim u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brëndshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve (për Universitetin Politeknik të Tiranës), Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit për shkak të rinovimit të ndërtesave publike ku, masat për eficiencën e energjisë janë detyruese në zbatim të ligjit 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Investimi për eficiencën e Energjisë

Mbi bazën e studimit SLED² të vitit 2015 (Support for Low Emission Development in South Eastern Europe), analiza e stokut të ndërtesave publike

² http://sled.rec.org/documents/SLED_Albania_BUILD_ALB.pdf

tregon se në Shqipëri janë rreth 6300 ndërtesa publike dhe sipërfaqja totale e tyre është rreth 2.146.000 m².

Ndërtesat publike për qëllime të performancës (ngrohje, ftohje, ujë i ngrohtë, ndriçim dhe ventilim) kanë sot një konsum tek 50-60 kWh/m²vit dhe konsumojne afersisht 128 800 MWh/vit energji elektrike dhe termike (nga djegia e lendëve djegëse). Me ane të kerkesave minimale parashikohet të rritet ndjeshëm komforti termik, uji i ngrohte, cilesia e ajrit në mjedise dhe ndriçimi sipas standardeve. Kjo situatë parashikon që ndërtesat duhet të shpenzojnë rreth 180-200kWh/m²vit, dhe për të rritur eficientë e energjisë, bazuar në strategjinë e energjisë dhe arritjen e objektivit kombëtar në sektorin e shërbimeve për vitin 2030, kërkohen mjete financiare të cilat parashikohen në buxhetet përkatëse për rikonstruksion dhe/ose rinovimin. Objektivit për të rinovuar deri në 2 % të stokut të ndërtesave publike do të thotë se të pakten cdo vit do të rinovohen rreth 100,000 m² sipërfaqe ndërtimesi të cilat duhet të parashikojnë masa të eficientës.

Në qoftë se nga stoku i ndërtesave publike rinovohen 0.1 milion m² çdo vit, shpenzimet totale nga buxheti parashikohen të jenë rreth 28,000 lekë/m² (124 EUR/m² rikonstruksion dhe 100 EUR/m² eficientë) ose në total rreth 1.9 miliard Lekë (rreth 15.2 Mil EUR), nga të cilat **investime për eficientë parashikohen rreth 1 mld lek në vit** (rreth 8 Mil EUR). Nderkohe Plani Kombëtar për Eficientë e Energjisë i 2-të dhe i 3-të, parashikonte gjatë 2017-2020 një kosto rreth 40 Mil EUR për masat në sektorin e eficientës së Ndërtesave.

Nga analizat e auditimeve energjetike të ndërtesave është gjetur se ndërtesat publike shpenzojnë energji me performancë të ulët (rreth 250 kWh/m²vit) pra rreth 3,000 lekë/m² në vit konsum energjie. Kjo do të thotë që për sipërfaqen 0.2 Milion m² ndërtesa publike, **shpenzohen të pakten 600 mil Lekë/vit për të furnizuar me energji këto ndërtesa** në kushtet e mungesës së performancës energjetike.

Kursimet e energjisë si rezultat i masave të EE

Rinovimi i këtyre ndërtesave sjell kursime në energji ndër vite dhe nga analiza e kostove optimale duket se, nëpërmjet rinovimit është e mundur të kursethet rreth 50-60% e energjisë çdo vit e cila sipas parashikimeve të buxhetit, rikuperon brenda 8-9 viteve koston e rinovimit së bashku me vendosjen e sistemeve teknike të përparuar. Ndërhyrjet, me qëllim kursimin e energjisë në nivelin të paktën 50-60% do të thotë se nga buxheti do të **kursethen të paktën 360 Mil lekë në vit** (ose rreth 2.9 mil EUR në vit).

Pra, nga investimi gjatë tre viteve të njëpanjëshme prej 3 mil lekë nga buxheti i shtetit do të krijohet një fond prej **1 mld lekë** nga kursimet e energjisë. Nga një bilanc investimi për eficientë energjie prej 9 vitesh, 6 miliard lekë do të shpenzoheshin nga buxheti i shtetit dhe 3 miliard lekë nga fondi i kursimeve të

energjisë. Pra, mbas 9 vitesh lekët e grumbulluara nga kursimet e energjisë do të shërbenin për investime të reja në këtë fushë. Kjo quhet ndryshe edhe “*Revolving Fund*” për të cilin institucionet financiare mund të vendosin të japin kredi të buta.

MINISTRI



Belinda Balluku

